



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
Prirore - Prinjmeno M&Dona	23.07.2021		
Nr.i organit Org.broj	Numeri/Sroi	Shtojce Prilog	Vlera Vrednoset
01	060/01-509		



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 të Ligjit Nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershori, 2008), dhe të Nenit 30, paragrafi 30.2 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011 dhe të Nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, në Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e VI të rregullt të Kuvendit të Komunës së Vitisë, që do të mbahet me datën **30.07.2021 (e Premte)**, duke filluar në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Sallën e Kuvendit të Shtëpisë së Kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në Viti.

Për këtë seancë kryesuesi propozon këtë:

R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e pestë e Kuvendit komunal të Vitisë**
- 2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-qershori 2021.**
- 3. Propozim vendim për caktimin e komisionit për intervistik, vlerësim dhe poentim të kandidateve të cilët kanë konkurruar në konkurset publike për pozitat drejtor, zv drejtor të shkollave fillore - mesme dhe çerdheve të fëmijëve të Komunës së Vitisë.**

Viti, më 23.07.2021

Kryesuesi i Kuvendit
Naim Pira





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË PESTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më 29.06.2021(e Martë) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, Kryetari z.Sokol Haliti, nënkyetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Zejnepe Osmani, Valbona Haziri, Ramadan Deliu, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Taibe Ibrahim, Zekirja Zuka, Bajram Sokoli, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Lindita Demelezi, Liridona Bislimi, Remzi Salihu, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Valentina Hasani, Rasim Terzqi, Besim Ymeri. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtoret e drejtive, mjetet elektronike, zyrat e kryetarit.

Pasi u konstatua se prezent janë 26 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e katër të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë. Më lejoni të përshëndes nënkyetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtore të drejtive të cilët janë prezent në këtë seancë, mediat elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Zyra Ligjore e MAPL-së na i ka konfirmua ligjshmérinë e disa akteve që i kemi miratua në seancën e kalume. Rregulloren për këshillat e fshatrave e ka kthye në rishqyrtim. Sigurish ne seancën e radhës e sjellim.

Sekretaria: Kryesuesi i njoftoj me gjendjen aktuale me Covid 19 në komunën tonë.

Kryesuesi, z.Naim Pira: Tani kalojmë tek pyetjet dhe përgjigjet, fjala është për ju.

z.Jakup Demiri: Pyetja e parë shkon për kryetarin por pasi që nuk është kryetari po e shtroj për nënkyetarin qka keni ndërmarr si komunë ne që kemi dëgjuar prej një portali lajmi.net është fjala për shefin e prokurimit ne kemi informatë se ju është marr licenca kjo ka të bëjë drejtëdrejt me zyrën e kryetarit, pyetja e dytë shkon për drejtoren e financave qfarë ka ndodh me një vendim që e kemi marr që ka pas të bëjë me kompensimin e familjeve që kanë humbur një familjar me covid 19 , kam një kërkesë për drejtoreshën e shëndetësisë kemi kërkuar një listë të punëtoreve shëndetësor marrëveshje me karitasin nuk e di pse ajo listë nuk sjellët, edhe pyetja tjetër në projekte nëpër fshatra në rrugët që po riparohen nuk e di pse dinamika e punës nuk është ma e madhe.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje për gjithë të pranishmit në këtë seancë , është seanca e shtatë që kemi kërkuar listën me Karitas po nuk po e kërkoi prej drejtoreshës pasi që është seanca e parë por besoj se për seancën e ardhshme listën komplet do të na i sillni, një pyetje në lidhje me shërbimet e varrimit në konsultë edhe me bashkësinë islame për vitin 2021 asnjë pagesë nuk është bërë është një përgjegjësi jashtëzakonisht e madhe edhe e komunës edhe e Bashkësisë islame sepse çështjet e varrimit janë shumë të ndjeshme, dhe pyetja tjetër për drejtoren e financave në bazë të qkahit janë bërë këto punësime në muajit e fundit që nuk kemi parë konkurse.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje për gjithë të pranishmit në këtë mbledhje në këtë seancë do ta bëjë një shkelje

gjithherë i kam bërë ka dy pyetje kësaj here do ti bëjë tri , pyetja parë për drejtorin e inspeksionit e dimë që ka filluar sezona e verës dhe po më intereson që inspekzioni a ka ba inspektimin e pishinave që a i plotësojnë kushtet petja e dytë drejtorit të arsimit rrëth testit të maturës si ka shkuar ecuria ,dhe tjetra ka të bëjë me shëndetësinë më intereson numri i të vaksinuarave , numri i të vaksinuarave në pjesën e dytë që ka pas me ardhur edhe ajo që po prolongohet se ka filluar vaksinomini masiv a në teren është e kundërtë

z.Taulant Haxhiu: Unë po lidhem me temën kryesore super skandalin që ka ndodhur në Komunën e Vitisë që ju ka marr licenca shefit të prokurimit kështu a keni marr najë masë a është duke punuar hala ai se moment se ju ka marr licenca ai ka bërë keqpërdorime unë në dy tri seanca edhe atë fjalë që ja kam thanë në seancë para një viti dul se është e vërtetë , i nderuari Aliu për semaforët të kam thanë para dy seancave se ata semaforë nuk janë në vendin e duhur edhe nuk kanë me qenë funksional unë e kam shtëpinë aty çdo ditë kaloj aty ata semaforë janë jashtë qdo funksioni , punësimi sidomos tash që jemi në vit zgjedhor këto ditë Komuna e Vitisë ka pas kontrata mbi vepër ma shumë se komuna e Stambollit tu kisha lutë drejtor të gjitha kontratat që janë te KARITAS-i, te Zjarrfikësit , të gjitha në seancën tjetër i dua me emra e me mbiemra .

znj.Xhylsime Qamili: Unë kamë një pyetje për drejtorin e inspeksionit a jeni duke menduar me vendos tija për kalimin e këmbësore te rruga ku janë edhe qendrat tregtare dhe sinjalizimin vertikal për qytetaret kuptohet gjithë herë duke e zbatuar ligjin , kam edhe një pyetje tjetër për ju drejtor qfar po ndërmerr inspeksioni për sigurimin e ushqimeve ku këto ditë kemi rritje të temperaturave dhe pritet ardhja edhe nga diaspora .

z.Basri Sylejmani: Unë kisha me bë pyetje drejtorit të inspeksionit për taksistet të cilët janë në shesh duhet të bëjmë diqka për ta se policia është duke i dënuar për çdo ditë taksistet .

z.Ekrem Abazi: Po ju kërkoj falje në fillim se ndoshta e kam tepruar me çështjen e ujit por me të vërtet edhe ju që jeni kompetent që jeni persona përgjegjës kjo është e tepërt qka jeni duke na bërë neve si qytetar të Komunës së Vitisë ka një vit që është rregulluar gypi i ujësjellësit nga Letnica ujë fare nuk kanë qytetaret deri kur do të luani me ndjenjat e qytetareve, tjetër në fshatin tonë nga Skifteraj në Stubëll të Poshtme u rregulluar pak asfalti që është prishur në të gjitha vendet por sot me dal me shikuar në qfar gjendje është ajo rrugë vetëm në 2/3 vende ka intervenuar sa me than që intervenova po atë rrugë ma së miri është me asfaltuar prej fillimi është katastrofë nuk ka nevojë fare aty me qenë ingjiner e sheh në qfar gjendje është , lagjja jonë qe ditë nuk ka ndreqim fare nuk ka dal askush me shikuar por nuk po befasohem se i kam par edhe gropat kur i kan mbyll vetëm i stërpikshin nga pak nuk patë aty asnje mbikëqyrës e nuk po befasona edhe ndriçimi nuk banë .

z.Nuredin Lutfiu: Kam një kërkes nga këshilli organizativ Kenan Halimi në Skifteraj turniri që mbahet pernder të ramjës së tij ka një kërkesë për rritjen e tribunave sepse qdo vit ë ma shumë po shthohet numri i shikueseve, te ndriçimi publik kam një karkës nga banoret e fshatit Skifteraj dhe ne fshatin Remnik ndriçimi i lagjeve ne shumicën e vendeve mungojnë poqët elektrik , edhe një kërkesë tjetër nga banoret e fshatit skifteraj për lidhjen me asfaltim në rrugën e cerealit e cila ka vetëm 200 metra pa asfalt edhe kërkesa tjetër prape nga banoret e fshatit Skifteraj kur është bërë riparimi i rrugëve nëpër fshat nuk i ka përfshi gjitha lagjet nuk e di a nuk janë në sistem a çka është problemi i tyre.

z.Remzi Salihu: Unë nuk kam diçka te veçante nga parafolësit qe ishin por kisha me bë një pyetje rrëthë semaforëve se u diskutua shumë pse nuk janë funksional, dhe kam një shqetësim tjetër i cili na shoqëron që nga fillimi i punës në këtë Kuvend kam bërë kërkesë në qasjen në dokumente publike dhe në bazë të kërkesës kërkoj një informatë me shkrim nga komuna e Vitisë..... dhe listën nga Karitas për listën e personave që përfitojnë nga Karitas Kosova mua më kanë dhënë një dokument po nuk pasqyrojnë asgjë vetëm se shkruajnë edhe kemi shifra a nuk kemi as nënshkrim as vulë për personat që paguhën nga Karitasi kam qenë personalisht te drejtoresha, drejtoresh urime për postin se ndoshta klienti i parë do të jem unë te ti se prape do të interesoheni gjithashtu kam qenë edhe te Karitas Kosova në Ferizaj kam bërë kërkesë atje dhe ende nuk është shqyrtuar kërkesa ime qfarë do të marr nuk e di , pyetja konkrete pse drejtor po me neglizhon

z.Sejdi Emini: Edhe unë i kam disa pyetje dhe kërkesa e para ka të bëjë me taksitë unë personalisht kam mbajtur një takim ku ka qenë kërkesë e tyre kjo pjesa ku janë te sheshi unë mendoj se ajo është pengesë për qytetaret sepse tash edhe sheshi po frekuentohet mjaft shumë dhe qytetaret po kanë pengesë me hy se po shkojnë me familje me fëmijë është e domosdoshme me i larguar nga aty por është e domosdoshme me ju be një vend prej shtëpisë së mallrave deri te qeshmja që është aty është kërkesë edhe qeshmjen me ja ndreq aty se nuk ka ujë, pyetja e dytë ka të bëjë me trotuarin ke than para dy muajve qe ka kaluar është fjala për Gushicë desha të dijë kur do të filloj, kam kërkesë edhe për fushën në Sadovinë që të pajiset me disa parkingje sepse mjaft shumë është e frekuentuar dhe shumë shkolla të futbollit po zhvillojnë tash aktivitete dhe të meremetohet pak sepse është dëmtuar mjaft shumë , një kërkesë tjetër është për një shkollë të Muzikës është kërkesë e kamotshme duhet me i shtjerr krejt mundësit dhe me ba sepse është shumë e nevojshme .

znj.Liridona Bislimi: Kam një kërkesë për drejtorin e inspeksionit banoret e fshatit Sllatinë konkretisht në rrugën e Dardanisë kérkojnë që të vendosen shenjat e policit te vdekur sepse po e shohin atë rrugë mjaftë të rrezikshme , qështja e taksisteve që u ngrit ma herët nga koleget ju bashkëngjitet edhe unë edhe unë kam pas takime me ta dhe ata e ndiejn vetën të harruar nga institucionet tash jemi në kohen e verës dhe prerja e barojave komuna duhet të dal dhe ta shoh si është gjendja sepse afër rrugës është rritur shum bari dhe është vështirësuar edhe shikimi në rrugë.

z.Vehbi Rama: Unë kisha me ba një pyetje pse trotuari te rruga Rexhep Bislimi është dëmtuar kur është hapur kanalizimi , tjetër pse ambulantë në Zhiti qe 8 vite është kërkesë e imja edhe banoreve edhe është premtuar dhe nuk është hapur , tjetra gjatë pandemisë kemi pasur shumë humbje me lejoni të ju shprehi ngushëllime familjeve nder ta kemi pasur edhe mjek ndër ta edhe Fetih Hetemi dhe Fadil Zuka dhe një punëtor teknik Fetih Bajrami unë kisha propozuar se këta ti përkujtojmë me një pllakë përkujtimore te shtëpia e shëndetit në Viti.

znj.Hidajete Pira: Unë kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike qka është problemi i ujësjellësit në Pozheran 1 dite kem 10 ditë nuk kemi edhe kur kem komplet i turbullt është unë vetë kam kërkuar në QMF me më sjell me cisterna nuk mu kanë përgjigjur kisha dashtë me marr një përgjigje qka është problemi

z.Ali Bajrami: Vehbi atë që e parashtrove ti qëndron dhe mbetet me u pa mundësit që me u intervenuar aty Kryesuesi, **z. Naim Pira:** Faleminderit për pyetjet e parashtruar! Po ja kaloj fjalën nënkytarit.

Nënkyetari, z.Hasan Aliu: Edhe se po e shoh se gjitha pyetjet janë me interes të veqant dhe numri i tyre ka arrit 35 unë do të bëjë përpjekjeje ato të cilat janë të shtruara në nivel të kompetencave të kabinetit të kryetarit edhe pjesën tjetër do të përgjigen drejtoret e drejtorive përkatëse, ajo që na gjzon ma së shumti se tash në Viti kemi vetëm një rast pozitiv me covid, pyetja e parë që është shtruar në adresë të kryetarit qka keni ndërmarr ju për shefin e prokurimit lidhur me pezullimin e licencës për të ushtruar funksionet e i-prokurimit duke i respektuar të gjitha institucionet edhe ato të shkallës së dytë kabineti i kryetarit ka qenë në përcjellje të këtij rasti por janë disa rregulla juridike kur pala e pa kënaqur ka të drejt të parashtroj ankesë dhe po ju njoftoj se personit në finalë ju ka kthyer licenca ne nuk e kemi vendosur këtë qështje, në lidhje me pyetjen e dytë shumë shpejt kryhet edhe ajo për pagës brenda ditëve , lista me Karitas po konsideroj se në rrugën ma të mirë të mundë tash paska shkua këshilltari Remzi Salihu që konsideroj se ka me marr listën e plot, projektet të cilat po realizohen kërkoi me dinamik ma të shpejt edhe unë pajtoj se edhe ne bëjmë përpjekje çdo ditë, shërbimet e varrimit është e vërtet se një pjesë ë grumbulluar shumë shpejt edhe kjo kryhet, punësimë me kontrata 21 i ka kërkuar zyra e personelit jemi mungesë prej atyre që kanë pas rast me humbur jetën me covid dhe mungesa e infrastrukturës ligjore në nivel të Kosovës të cilët nuk e kanë pajisur dhe nuk kemi pasur asnjë të drejtë me qit konkurse dhe qka është me rendësi edhe ato që i bajshim me procedurë të thjeshtuar na i kanë refuzuar dhe jemi të obliguar me ligj tjetër të veprojmë dhe ti marrim me kontratë mbi vepër, Taulant u thirre në atë që e ke qëlluar kësaj here se ke qëlluar te shefi i prokurimit, semaforët nuk janë në vendin e vetë kurrë nuk jam thirr se jam njeri përgjegjës vetëm se kam qenë idhetar për vendosjen e semaforëve në komunën e Vitisë në veçanti këtë mund ma së miri me kuptuar

Bekimi dhe të gjithë ata që ushtrojnë në Auto shkolla , te qështja e taksisteve që u shtrua nga $\frac{3}{4}$ këshilltar e ngritën jo që nuk po dua me tu përgjigje por kryetari e ka caktuar një komision për vendosjen e taksisteve është vonuar po me një të ardhme shumë të shpejt do ta rregullojmë, Ekrem i kemi pas një tri a katër seanca çështjen e ujit ta kam than po ta përsërisë prape shumë ma shumë se ti jemi të interesuar me krye, rruga për Skifteraj – Stubëll unë e di se me të vërtetë aty u dëmtuar shumë rruga por një qështje duhet ta kemi parasysh se ne kemi arrit me dërgua asfaltin aty , qështja e ndriçimit Kemajl Azizi unë po konsideroj se drejtori është këtu dhe do të përgjigjet, rritja e tribunave ne Skifteraj me të vërtetë është një turnir i mirë tash duhet me shti në kornizë buxhetore, semaforët a janë në defekt nuk e di nëse me lejoni në seancën tjetër do ti marr informatat trotuarin në Gushicë nëse i ka kaluar procedurat besoj fillon shumë shpejt për mirëmbajtjen e stadiumeve kemi me ndërmarr diqka për shkollë të muzikës drejtori është këtu duhet me shikuar udhëzimin administrativ ato që i propozove për emra janë komisioni për emërim sa i përket ujësjellësit u dashtë me i thirr ata të hidro Moravës të kishin njoftuar

Kryesuesi, z. Naim Pira: Faleminderit nënkyretar! Tash ja u kaloj fjalën drejtoreve rrathë pyetjeve.

z.Sknder Ahmeti: Sot në drejtorin tonë u adresuan disa pyetje , pyetja e parë ishte nga Ali Bajrami i cili po pyet për pishinat unë me bindje të plot ju them se sot inspektori sanitari është në vizitë të pishinave se dy pishina i kemi në territorin e Komunës së Vitisë pyetja e dytë është nga doktoresha Xhylë e cila shtroi pyetje përrugën e Preshevës Viti -Kllokot për shkak se po kemi shumë shpesh aksidente kjo po kërkon a janë të planifikuara vend kalimet përkëmbësor dhe sinjalizimin në komunikacion po të them me përgjegjësi të plot se vend kalimet do ti vendosim por edhe kufizimin e shpejtësisë pyetja tjetër ishte për inspekthin e ushqimeve edhe këtu jemi vazhdimisht në inspektim dhe po ju them se gjatë këtyre 6 muajve mbi 30 ton ushqime i kemi konfiskuar që skam pas afat për përdorim , Basriu pyeti për taksistet desha ti tregoj se është një grup punues edhe ai e ka për obligim rregullimin e taksisteve , Liridonë e pashëndet për angazhimin që e ka si asamblistë se shpesh e viziton drejtorin e inspeksionit për problemet e qytetareve por po ta them se po na sjellin shume administrator të fshatrave dhe shumë qytetar për polic të shtrire na sjellin kërkesa unë po të them se rrugët që janë të pajisura me tretuar dhe me ndreqim nuk guxojmë me i lejua vendosjen e policeve të shtrire .

z.Ibrahim Rama: Disa pyetje që u banën për ekzekutivin u përgjigje nënkyretari por unë do të mundohet në ato ku i përket drejtorisë ku unë e udhëhiqi , e para nga Jakupi për pagesën e familjeve që kanë humbur anëtarët nga covid 19 na është kërkuar nga ministria e financave që këto pagesa mos të kryhen një nga një të grumbullohen një numër prej 50 vetave listën e këna bë unë besoj brenda 2 dite kryhen, një pyetje tjetër ka të bëjë me shpenzimet e varrimit të bashkësisë islame të Kosovës po është grumbulluar një borxh por ne mungesë të punëtorit cili ka vdekur nga covidi për atë s'kemi mund me i kryer pagesat , një pyetje tjetër ka të bëj me kontratat e borxh Taulanti unë javë kam sjell gjithherë edhe kësaj radhe do ta keni sigurisht një tjetër ishte nga Ekrem Abazi për ujin e pijshëm unë e kam shpjeguar edhe në seancën e kaluar na e këna një marrëveshje me CDI-në edhe Hidro Moravë dhe në atë pikë shkruan se 14 vendbanime duhet me qenë të përfunduar deri me 30 gushtë, edhe Sejdiu që pyeti për trotuarin në Goshicë po të njoftoj se po është i paraparë përvitin 2022, dhe ne fund ju përgjigjem edhe profesorit po ju them se gjithherë ju jam përgjigje kérkesave të juaja si me shkrim ashtu edhe me gojë dhe e din se na ja kemi dhanë një përgjigjeje.

znj:Vjollca Kadolli- Halili: Pasi që kam qenë e lidhur ma shumë edhe në pyetjet që parashtuat ju një pyetje që është duke u bërë lista e të punësuarave me Karitas. Unë po ju them se është e drejtë e plot e Karitasit me mbajt listën unë e kam listën komplete por nuk kam drejtë më e qitë në publik se është ekskluzivitet i Karitasit, kisha dashtë me falënderuar kryetarin e Komunës edhe institucionet përkatëse që na kanë mundësuar vazhdimin e lidhjes me karitasin sepse në ketë kohë që kemi kaluar na ka ndihmuar shumë , sa i përket të vaksinuarave na deri sot jemi pajisur me 4598 vaksina deri sot janë vaksinuar 2560 qytetar sot kemi shkuar me u furnizuar prap me vaksina, terminët caktohen ekskluzivisht nga ministria e shëndetësisë qytetaret janë të obliguar të aplikojnë

online në e- Kosova gjithashtu janë edhe kategoritë që janë të caktuara vetëm nga ministria e shëndetësisë , në Zhiti kemi punuar dhe jemi bërë gati për ta hapur ka qen edhe një kërkesë e imja që mos të hapet sepse jemi detyruar të gjithë mjejet ti tërhiqmi që ti stacionojmë në viti .

Kryesuesi, z.Naim Pira: Faleminderit drejtoreshë për këto informacione unë e di se gjithmonë ekzistojnë dy të vërteta kur parashtronhet pyetja një e vërtetë është e atyre që e parashtron pyetjen dhe një e vërtetë e atyre që japid përgjigjeje vetëm se desha të ju tregoj se auditori jashtëm përsëri na ka shpallur një nder komunat ma të mira unë e di se një pjese nuk i pëlqen kjo

z.Ibrahim Rama: Vetëm një përmirësim apo llapsuz është fjala për trotuarin në Goshicë ai nuk do të bëhet në vitin 2022 po në këtë vit pra në vitin 2021 . tash nga një minutë javë jap fjalën juve

z.Ekrem Abazi: Te rruga nënkyetar edhe unë para lufte kam menduar se veqëndërrës është ajo punë se nuk kam ëndërruar fare që ajo rrugë me u shtruar por pas lufte gjithmonë e kam zanë atë realitet edhe u bë realitet se e ka merituar dhe po të tregoj se janë ndërtuar tri katër shtëpi vitin e kaluar , se thatë nuk ka pasur pare tenderi ka dal me të gjitha rregullat që ekziston po punë kryesi nuk e ka plotësuar asnjë standard të atij tenderi që e ka marr dhe aty është bërë një hajni shumë e madhe nga njerëzit e tanë kompetent edhe nga punë kryesi, te uji drejtor i financave nuk kërkova unë për 14 fshatra po kërkova një sqarim pse nuk furnizomi prej gypi të ri , te ndriçimi që 10 ditë nuk ka ndriçim

z.Basri Aliu: Përshëndetje për të pranishmit në ketë seancë! Unë kisha një pyetje për testin e Maturës sa për informacion testi i maturës është mbajtur me 206.06.2021 nuk kemi pasur asnjë problem , testit të maturës ju kanë nënshtruar 509 maturantë për rezultatin do të presim ta shohim si është , ndërsa një pyetje tjetër ishte nga këshilltari Sejdi Emini në lidhje me shkollën e Muzikës ne i kemi marr disa iniciativa së bashku me shkollën e Gjilanit në mënyrë që ta bëjmë një marrëveshje që ta hapim edhe një paralele në Viti.

z.Nexhmedin Jakupi: Përshëndetje për të pranishmit në ketë seancë në shumicën e pyetjeve u përgjigj nënkyetari edhe ju kryesues në lidhje me ujin në Pozheran vetëm desha të lidhem te Ekremi për ndriçimin publik aty mund te ndodhin defekte dhe duke ditur sa shumë kemi rrejte të ndriçimit duhet me kuptua se mund te ndodhin edhe prishje por po të them se shumë shpejt do ta sanojmë atë defekt.

z.Jakup Demiri: Te kjo puna e listës e punëtoreve me karitas unë e kam kërkuar në seancën e fundit që është mbajtur para dy muje unë nuk e di qfarë marrëveshje sekrete është qka e pengon ajo , e dyta kryesues po lidhem pak me ty se the që auditori jashtëm e ka qit komunën mirë kjo nuk është e vërtetë se edhe na e shikojmë raportin edhe ne jetojmë këtu edhe e dimë gjendjen ma mirë se kushdo tjetër që vjen nga jashtë , ne e dimë gjendjen e disa projekteve pjesa ma e madhe e kanalizimeve që 10 vite i ke të kryera dhe nuk kanë pranim teknik edhe nuk funksionojnë .

z.Sejdi Emini: Unë kam të bëjë me drejtorin e inspeksionit u tha si shablon sa i përket takside në atë pjesë si me qen kundër takside por qëllimi është që më ju lirua qytetareve kalimin dhe takside me ju ba vendin ku e ceka edhe ma herët .

z.Remzi Salihu: Desha me u ndërlidhur me drejtorin e financave paraprakisht dua me falënderuar për sugjerimin apo vrejtjen që ma bëri kurse përdrejtorin e financave përmos me zgjatur ma tepër drejtorin e arsimit e paska afër ka pas mundësi me pyetë se mu duk se diçka rreth nxënëseve e përmendi përfoma , po të këshilloj drejtor të bëhesh këshilltar i imi atje veq nuk e di a mund të merremi vesh se unë aty flas frëngjisht .

z.Taulant Haxhiu: Unë e pash se sot nënkyetari na i ka kthyer përgjigjen si në miting politik, përvendimin i ndaruari nënkyetari po të them asnjëherë kur ta parashtron një pyetje nuk e bëjë vëq për politik unë me 23.06 2021 e kam marr vendimin që ju ka kthyer z. Abazit ma ka dërguar Kenan Gashi po dy seancë nuk keni qenë prezent , tash ne vitin 2021 me u ba skandal një shefi i prokurimit na duhet me debatuar se aty ka pasur diqka që është bërë ajo e dyta për punën e semaforëve këta janë rregulluar për komunikacion jo për auto shkolla se për to e kemi poligonin e treta z.Ramiqi kontratat unë kam dëshirë me i punësuar 5 mijë qytetar të komunës sime por

dua ta di ata qe janë duke marr mjete nga komuna a janë duke punuar apo janë duke nejtë në shtëpi .

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Nuk dua me tu kundërvu vetëm desha me u sqaruar eshtë e vërtet në bazë të asaj që ti po e merr se qysh nuk eshtë e mundur me ti dhanë rexhistrat këta të karitasit në aspekt ligjor eshtë qysh të ka than doktoresha , Kryesuesi e përmendi raportin ne do ta sjellim në kuvenit ju do ta shini, Taulant ti e ke dokumentin unë i besoj dokumentit i kam besuar edhe kur ja kanë pezulluar i kam besuar edhe kur ja kanë kthyer, listën që po e kërkon ke me marr prej meje vetëm të Karitasit mos ma kërko se atë nuk mundem me ta sjell

z.Ali Bajrami: Nuk jam profesionalist i lëmisë nuk isha lëshuar me atë mirë apo keq por kjo vendosja e semaforëve vetëm me dritë vezulluese që eshtë o i paralajmëron pjesëmarrësit në komunikacion që të jenë ma të vëmendshëm dhe prej se u vendosen semaforët nuk ka ndodh asnjë aksident aty

z.Nuredin Lutfiu: Unë desha një sqarim te drejtori i shërbimeve publike të asfalti që ka qenë nëpër fshatra a e merrni mendimin nga këshilli i fshatrave vendet ku janë dëmtuar

z.Jakup Demiri: Them se sot u sqaruam për listën e karitasit, sepse problemi ishte se deri sot nuk kemi pas asnjë përgjigjeje si ishte marrëveshja .

Kryesuesi, z.Naim Pira: Ju faleminderit për pyetjet e parashtruara për këtë seancë kemi paraparë këtë:

R e n d d i t e

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Kuvendit Komunal te Vitisë..**
- 2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizën afatmesme buxhetore (KAB), të Komunës së Vitisë 2022-2024.**
- 3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim-plotësim të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vitisë**
- 4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbështetje financiare për shpenzimet e strehimores Liria Gjilan për një periudhe trevjeçare 2021-2022-2023.**
- 5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2022.**

A ka dikush rrëth rendit të ditës? Pasi nuk ka e qes ne votim për miratim. Konstatoj se me vota unanime miratohet rendi i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e Kuvendit komunal të Vitisë

A ka dikush rrëth pikës se parë? Pasi nuk ka, me vota unanime miratohet.

Tash shkojmë në pauzë, në ora 13:00 vazhdojmë me seancë.

Po vazhdojmë me punimet e seancës së pestë. Pasi kemi koorum të mjaftuesh si pikë të dytë të rendi të ditës kemi

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për Kornizën afatmesme buxhetore (KAB), të Komunës së Vitisë 2022-2024

Ja kisha kaluar fjalën drejtorit rrëth kësaj pike.

z.Ibrahim Rama: Na, pjesa dërmuese që sa mandate jemi në dijeni që ka të bëjë me Kornizën Afatmesme Buxhetore, 2022-2024. Do të mundohem në pikë të shkurtra për me ju dhanë juve rrugë për debat, që fillimet i ka prej qarkores së parë buxhetore, që eshtë ardhur nga Ministria e Financave. Ky eshtë hapi i parë rrëth draftimit të

buxhetit në Komunën e Vitisë për vitin 2022 edhe projekcionet 2023/2024, është proces në të cilën na me qarkoren e parë duhet me i caktuar kufijtë maksimal, sa ka buxhet komuna e Vitisë për vitin 2022 dhe viteve tjera. Këto janë fillet që kemi me ba na deri me 30 shtator. Buxheti është dokument kryesor edhe kemi mbajt debate të shumta nga Komiteti për Politikë dhe Financa dhe nga qytetarët. Na kemi filluar vetëm me përgatitur, na e kemi shpjeguar shumë herë se, buxheti ndahet në komisione. Janë ato kritere bazë që janë hala në fuqi. Te shumica e drejtorisë kemi rritje. Vlen të ceket se, kemi rritje ma të theksuar. Kjo ishte në pikë të shkurtra. Për mos me ju marr kohë ma shumë po ja lam juve që të shtroni pyetje apo sugjerime rreth KAB-it.

Kryesuesi, z.Naim Pira: Faleminderit drejtor po e hapi debatin rreth kësaj pike të rendit të ditës

z.Ali Bajrami: para vetës kemi KAB-in për vitin 2022-2024 është dokument kryesor financiar për funksionimin normal të kuvendit dhe të gjitha institucioneve që janë në kuadër të komunës, në pasqyrat e paraqitura ajo që bien në sy është se financimi i komunës është nga grandet qeveritare dhe nga të hyrat vetanake kemi një rritje prej 578 mijë euro nuk është rritje ndoshta sa kemi nevojë por kur kthehet në përqindje 5.99% na mabetet ta menagjojmë dhe ta harxhojmë në mënyrën ma të mirë të mundur ajo qka është me rendesi te të hyrat vetanake deri tash kemi diku 54% besojm se deri në fund të vitit do të jetë një përqindje e mirë e grumbullimit, sa i përket specifikimit të projekteve kapitale është mirë me u bë por nuk ka pengës ligjore nëse shpenzohet sikur vitet e mëparshme.

z.Jakup Demiri: Në këtë pikë kemi kornizën afatmesme buxhetore e cila është padyshim ma e rëndësishmja e kuvendit komunal KAB-i është një dokument i cili përgatitet nga zyrtaret e administratës komunale dhe miratohet në parim në qdo viti nga asambleja komunale, ky material siguron një analizë të hollësishme të shpenzimeve publike dhe përcakton të arriturat dhe prioritet kryesore gjithashtu KAB-i siguron mekanizmat e nevojshme përmes të cilëve objektivat prioritare të identifikuara në dokument strategjik të komunës aty ku ekzistojnë të integrohen sa ma mirë në procesin buxhetor nga kjo tash na e kemi një pasqyrë si duhet të veprojmë nga e kaluara ne prej përvojë po flasim faqe 5 ku thotë te përmirësimi i standardeve të arsimit dhe nivelit të arritjes pajisjeve shkolllore dhe përmirësimi i bursave për student laborator te kjo e fundit unë e di se qe 7 vite tu qeverisë z.Haliti dhe nuk e di a ka pas ndonjë investim në laborator nëpër shkolla, ma poshtë e kemi te transporti, uji pijshëm apo rigjenerimi rregullimi komunikacionit ndriçimi publik këto e dini qysh është gjendja, transporti „ kanalizimi dhe uji të pijshëm te uji i pijshëm nuk e di vitin e kaluar nuk janë ndarë pare si kuvend komunal, tash edhe rrugët që janë shtruar na kemi shumë vërejtje, te qerdhet publike te premtuar kanë qenë katër emisioni jeta në Kosovë që është mbajtur e ku kam qenë edhe vetë prezent e rregulluar është vetëm një, te biblioteka salla e leximit e kemi përvëç Vitisë edhe Pozheranin Sllatinen e Eperme kisha thanë me ba diçka edhe për shkollat tjera ndërsa ndarja në sektor kisha me cek te inspektimi i tregut nga 2400 euro për këtë vit 600 euro, gjobat nga inspeksioni nga 2400 euro janë të parapamë 480 euro, inspektimi sanitar nga 1200 euro në 360 euro pse janë ndryshime kaq të mëdha, ndërsa te faqe 12 te pikë e tretë zbatimi i konceptit shumë vjeçar mbi planifikimin e projekteve kapitale na prape kemi me shkua te investimet kapitale por pa i caktuar paret mirë në projekte na e dimë se viteve të kaluara buxheti për investime kapitale nuk ka qenë i përcaktuar ne projekte sipas Mash-it këtë vit i kemi 204 nxënës ma pak a numri i mësimdhënësve është mbi numrin që mundet me qenë te shpenzimet kapitale është mirë të dakordomi sepse jemi edhe në vit zgjedhor dhe ti përcaktojmë shpenzimet kapitale me projekte ashtu si i ka hije, projektet aktuale të komunës dhe kosto në euro duhet të përgatitet pas dëgjimeve publike vetëm edhe një lutje që këto investime të dakordomi dhe ti cekim me projekte ku po i qojmë.

z.Bekim Azizi: Qarkorja e parë buxhetore parimisht buxheti që është paraparë për vitet vijuese unë do ta diskutoj vetëm të përgjithshmen nëse shikohet të hyrat vetanake të planifikuara 987 mijë euro nuk është përqindje e mir që ta planifikojmë buxheti që po vjen ndërsa pjesa tjetër është grand qeveritar pjesa ma e madhe e tyre është pjesa e pagave që edhe kjo nuk duhet të diskutohet mirë po pjesa tjetër që na mabetet ta diskutojmë është pjesa e investimeve kapitale në start nuk e kemi listën ku ti dërgojmë ku mund ti qojmë në investime kapitale edhe pse një pjesë të tyre na e dimë në bazë të projekteve dy vjeçare, pjesa shërbime mallra është që e kam shprehur shqetësim sidomos te pjesa e arsimit ku për numër të nxënësve janë diku 34 euro kjo është shqetësim se nuk i plotëson nevojat që janë të nevojshme për një vit shkollor për një nxënës është një kod që duhet të mendohet dhe duhet të jetë shuma ma e madhe pjesa tjetër e planifikimit zakonisht është e bazuar si viteve të tjera, te subvencionet prape shkohet njëjtë kjo dihet ka me shkuar por unë mendoj pjesa analitike kur ta planifikojmë buxhetin drejtor duhet të jetë edhe te shërbimet

dhe mallrat të mendojmë ka duhet me i qua ato pare pjesa tjetër te investimet kapitale mendoj qe duhet të jetë e specifikuar ketë vit sepse vitin tjetër nuk dihet kush do ta menagjoj ketë buxhet, unë mendoj se e kemi të miratuar edhe rregulloren pér mirëmbajtjen e varrezave prej vitit tjetër është mirë me paraparë edhe me buxhet , kemi edhe një rregullore pér persona me aftësi të kufizuara unë mendoj se duhet të mendohet edhe pér ketë kategori

Kryesuesi, z.Naim Pira: Dikush nga AAK a donë ta merr fjalën nëse jo a ka dikush tjetër të diskutoj pér KAB-in.

z.Remzi Salihu: Po shqyrtojmë KAB-in e cila është paraprijës e buxhetit pér vitin e ardhshëm por një kornizë e cila sipas meje është fare pak e detajuar dhe gjërat janë bërë krejt në përgjithësi në mënyrë të përgjysmuar megjithatë unë si sugjerim kisha me u ndal pak te sfera e arsimit po i jap disa vërejtje sipas të dhënavë që posedoja MASH-ti ka lejuar 620 pozita në arsim kurse këtu nuk figurojnë fare as nga MASHT-ti as nga Komuna pyetja është si do ta menagjoni këtë situatë dhe si është lejuar kjo tepricë apo ky numër kaq i madh nga ajo që ka lejuar ministria një shembull konkret po ju a jap te shkolla e Pozheranit klasa e dytë është një klasë prej 21 nxënëseve e cila është e ndarë në tri paralele shtrohet pyetja si është e mundur një klasë prej 21 nxënëseve të këtë tre mësues në vitin 2013 nuk kemi pasur asnjë pozitë a tepër prandaj këtë kërkoj që ta keni parasysh.

z.Ekrem Abazi: do te mundohem të jem i shkurtër dhe mos ti përsëris ato që u than nga parafolësit e mi, KAB-i po filloj te vizioni i komunës që mos me i lexuar të gjitha zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në bazë të qkahit po mendoni me pas zhvillim të qëndrueshëm ekonomik a me hap najë kafiq a qka unë mendoj se duhet të bëni çmos që tē punësohen njerzit të hapen vende pune të hapet ndonjë fabrikë pér prodhimin e diqkit në komunën tonë që ka nevojë e jo vetëm me kafiteri me i punësuar dy tre familjar , shërbime financiare të zhvilluara dhe krijim të kushteve të mira pér qytetaret e saj si bëhet shërbime financiare të zhvilluara qka keni menduar me këtë , përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale asistencë sociale pér familjet me nevojë që nuk kanë të ardhura dhe të ardhura të ulëta, buxheti pér vitin 2022 do të jetë afér 500 mijë euro ma i madh se vitin 2021 këtu shumica janë paga dhe mëditje nuk qon shumë pëspjh kjo, burimet e të ardhurave thotë të ardhurat në administratën komunale dokumenti zyrtar të ofiqarisë 2mijë euro në vitin 2021 a 3900 në vitin 2022 d.m.th. 100% ma tepër , kurorëzime 9600 euro kanë kushtuar gjatë vitit 2021 a në vitin 2022 vetëm 3960 euro shfrytëzimi i hapësirës publike 3600 euro vitin 2021 a në vitin 2022 7400 euro në bazë te qkahit e keni par këtë rritje, te tatimi në pronë u rrit kaq shumë a rritja e përgjithshme e të hyrave vetanake pér gjithë komunën e Vitisë prej të gjitha të tjerave është 126 mijë euro, më ra në sy te shëndetësia paga dhe mëditje te shëndetësia pér vitin 2021 janë 991185 euro a në vitin 2022 janë 952275 euro d.m.th. pér 40 mijë euro pagat dhe mëditjet në shëndetësi janë ma të ulëta në bazë të kujt e keni bërë këtë , më erdhi mirë te shpenzimet komunale i ka pas 95 mijë euro shëndetësia tash keni shkua në 40 mijë euro mallrat dhe shërbimet janë rritë që është mirë nga shpenzimet komunale janë kaluar te mallra dhe shërbime që është shumë punë e mirë kjo a shuma totale te shëndetësia është zvogëluar pér 10 mijë euro në krahasim me vitin 2021, të zyra e kryetarit ish i njëjti si në vitin 2021 d.m.th. kisha kërkuar të subvencionet mi hek te kryetari erdhi kush erdhi e me kaluar te bujqësia dhe shërbimet dhe mallrat një pjesë e vogël prej kryetarit me kaluar prape në shëndetësi.

Kryesuesi, z.Naim Pira: A donë dikush nëse jo drejtor u parashtrua një numër i pyetjeve me qene se kemi të bëjmë më një kornizë buxhetore po ta kaloj fjalën ty drejtor

z.Ibrahim Rama: uji i pajes ishte disa pyetje unë edhe në seancën e kaluar problematikat e ujit të pajes sigurisht që janë në agjendën e buxhetit të ardhshëm pér një arsyesh shumë të thjeshtë si territor Vitia ka ujë ma së shumti por sistemet e ujë sjellësit kanë defekte sepse shumë sisteme nuk janë kompletuar deri në fund ne e kemi bërë një marrëveshje me CDI dhe hidro Moravën me i rehabilituar 14 ujë sjellëse në komunën e Vitisë afati i përfundimit është fundi i gushtit jemi në bisedime pér sistemin e ujësjellësit edh pér 8 fshatra, qerdhet publike edhe këto janë prioritet, tē jenë të emëruara ne do të mundohemi që këto kërkuesat e juaja të implementojmë tu e zbatuar edhe ligjin, ishte një pjetë pér asistencën sociale në shëndetësi na fondin që na i ka caktuar ministria e shëndetësisë kemi 360 mijë euro realizohet plani 120% mundet me qenë keq pér arsyesh se planifikimi nuk është i mirë , shërbime dhe mallra në drejtorinë e arsimit unë ju thash edhe pér paga e kemi deficit fondin në arsim krejt fondi i arsimit na mungon diku

mbi 1 milion euro për shkak të numrit të punëtoreve që e kemi ma shumë , zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm e këna menduar sa kemi fuqi e këna hekë taksen me vendimin e juaj pjesën tjetër të zhvillimit ekonomik është përgatitja e zonës ekonomike Burikë , situata në arsim u mundova me shpjeguar e di se sektori i arsimit ka probleme financiare përveç asaj edhe reforma në arsim është një problem kjo ishte në pikë të shkurtra.

Kryesuesi, z.Naim Pira: Meqenëse nuk ka pyetje të tjera dhe kemi të bëjmë me një kornizë buxhetore e cila forem e vërtet të ligjit do ta merr atëher kur votohet në kuvend unë ju kisha sugjeruar ta kalojmë se kemi të bëjmë me një dokument që varet e ardhmja e njerzeve që janë tu punuar me mbetet mua ta hedhin në votim me 20 vota pro dhe 6 abstenime kalon kjo pikë e rendit të ditëes , si pikë të tretë të rendit të ditës kemi.

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim-plotësim të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës së Vitisë

Është një rregullore të cilën e kemi miratuar në kuvend, po për shkak të një pasuesi por është zyrtari këtu ja kisha dhanë fjalën.

z.Burim Sadiku: Rregullorja për rregullimin e këshillave të fshatrave ka kaluar në kuvend. Sekretaria e ka dërguar për ligjshmëri në MAPL. Ata na i kanë kthyer si të paligjshme për arsyen e numrit të banoreve e cila është në kundërshtim me udhëzimin administrativ te nenin 4, ku thotë se komuna e Vitisë nuk mund të ketë ma shumë se 20 këshilla të fshatrave. Pjesët tjera të rregullores mbesin të pandryshuara.

Kryesuesi, z.Naim Pira: Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush?

z.Ali Bajrami: Ajo çka me ra në sy, themelimi i 20 këshillave të fshatrave. Burimi e përmendi që në bazë të numrit të banoreve a bahet për numër të banoreve apo për lokalitet të caktuara se në rregulloren e mëparshme ka qenë e cekët saktësisht për sa banor duhet të jetë një këshill i fshatit edhe sa anëtar duhet me i pas ai këshill

z.Burim Sadiku: Është e rregulluar në bazë të numrit të banoreve është në bazë të udhëzimit administrativ edhe ne nuk mundemi me i ik asaj.

Kryesuesi, z. Naim Pira: E hedhin ë votim kush është që të miratohet kjo pikë e rendi të ditës. Konstatoj se me vota unanime miratohet.

Si pikë tjetër të rendi të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për mbështetje financiare për shpenzimet e strehimores Liria Gjilan për një periudhe trevjeçare 2021-2022-2023

Pasi nënkyetari shkoi, kjo ka të bëj për një shum prej 10 mijë euro ku pjesën dërmuese e ka mbuluar komuna e Gjilanit dhe neve edhe Kamenicën na mbetet ta mbulojmë pjesën tjetër por e hapi diskutimin rreth kësaj pike të rendit të ditës

z.Remzi Salihu: Unë kisha vetëm një sqarim se nuk po e shohë që është e përpiluar mirë qka nënkupton kjo shuma 2500 euro se këtu është e cekur për vitin 2021 a në memorandum është deri në vitin 2023. Te pika tre kur e sheh është një mospërputhje mes propozimit dhe memorandumin.

znj.Xhylsime Qamili: Për periudhën trevjeçare për strehimore 2021.2022.2023 obligime të komunës te nenin 3 thuhet për vitin 2021 ka obligim 2500 euro.

z.Remzi Salihu: Unë nuk jam duke e kontestuar ketë vetëm dua ta sqaroj se propozimi i kryetarit bie ndesh me memorandumin sepse këtu thotë për një periudhë tri vjeçare ne vlerë prej 2500 euro unë po e di qka po kërkohet po të jetë formulimi konkret d.m.th. kjo shumë jepet vetëm për vitin 2021 a në bazë të propozimit kjo shumë përfshinë tri vite.

z.Ali Bajrami: Te neni 2 ceket shuma për vitin 2021 d.m.th. 2500 euro a te pika 4 për vitin 2022 dhe 2023 përllogaritjet do të behën sipas nenit 2

z.Bekim Azizi: Nuk ka asgjë kontestuese memorandumi i mirëkuptimit është shumë i qartë pika 3 është e ndarë për vitin 2021 pika 5 për vitin 2022 dhe 2023 bëhen komisionet punuese deri me 20 janar e përcaktojnë shumën për ato mjete .

z.Ibrahim Rama: Unë po mendoj se, profesori e ka mirë edhe unë po propozoj memorandum bashkëpunimi. Është dokument tre vjeçar propozim vendimi duhet me qenë vetëm për vitin 2021.

Kryesuesi, z.Naim Pira: Këtu e ke nenin 3, ku thotë. Unë po mendoj se duhet ta tejkalojmë këtë. Na ja dërgojmë edhe Zyrës Ligjore. Kush është që të miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të fundit të rendit të ditës:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2022

Këtu duhet të propozohet një grup punuës prej anëtareve të kuvendit komunal nga zyra e kuvendit dhe një nga shoqëria civile. Po pajtohem që shefat e grupeve të jenë pjesë e grupit po e hedhi në votim për miratim : konstatoj se me vota unanime miratohet kjo pik , me kaq shpall te mbyll këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoj me punë në ora 14:20 min.

Vërejtje: Për shkak të problemeve elektro-teknike të sekretarisë, procesverbali nuk është lektoruar.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pronar - Primiljeni Mëdha	16.07.2021		
Nr.i organit Org.broj	Numri/Broj	Shtetëse Prilog	Vlera Vrednosat
02-402/01-501			



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA

Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-qershori 2021

Viti 15.07.2021



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA - MUNICIPAL VITINA



DREJTORIA E FINANCAVE

Data/Datum/Date	15.07.2021
Nr/Br.	
Për/Za/To	Kuvendin e Komunës, Komitetin për Politikë dhe Financa
Përmes/Preko/Through	Z. Sokol Haliti, Kryetar i Komunës
Nga/Od/From	Z. Ibrahim Rama, Drejtore i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim
Lënda/Predmet/Subject	Pasqyrat Financiare për periudhën janar-qershori 2021

Bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin mbi Financat Lokale si dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitetë paraqesim pasqyrat financiare të organizatës së buxhetore (657) për periudhen janar-qershori 2021 përfshirë të hyrat vetanake të realizuara si dhe shpenzimet buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike.

Të hyrat

Gjatë periudhës janar – qershori 2021 janë inkasuar gjithesej të hyra vetanake në vlerë prej 496.164,38€, shkalla e inkasimit, duke u bazuar në planifikimin vjetor është 57,61%, ndërsa Krahasuar me të hyrat për periudhën janar – qershori te vitit 2020 te hyrat e vitit 2021 janë me te larta per 221.961,93 €

Shpenzimet Buxhetore

Buxheti i Alokuar për periudhen janar – qershori te vitit 2021 nga fondet burimore: Granti qeveritar, të hyrat vetanake, dhe donacionet janë: 7.170.964,51€, ndersa shpenzimet janë: 5.391.790,68€ , shkalla e ekzekutimit te buxhetit per periudhen janar- qershori 2021 eshte 75,19% në krahasim me Alokimet për të gjitha programet dhe kategoritë ekonomike.

Në vazhdim të këtyre pasqyrave në mënyrë tabelare do ti paraqesim shpenzimet buxhetore, duke i specifikuar sipas burimeve te financimit, programeve dhe kategorive Ekonomike.

Buxheti i Aprovuar,Alokuar dhe i shpenzuar per te Gjitha programet buxhetore - janar-qershori 2021

Aprovim

	Kateg.&Ekonomik e	Aprovime 10	Aprovime 21	Aprovimet 22	Aprovimet Donacionet	Totali i Aprovimeve
1	Pagat &Shtesat	7,625,412.41	0.00	0.00	881.90	7,626,294.31
2	Mall.&Sherbime	1,773,949.00	145,000.00	66,093.66	1,908.82	1,986,951.48
